

20250861880

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL

Neni 1

Në Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/02, 85/03, 40/04, 113/05, 29/07, 88/08, 48/09, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15, 30/16, 21/18, 245/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/19 dhe 103/21), në nenin 7, në paragrafin (2) dhe në nenin 47, paragrafi (1), në pikën g) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve”.

Neni 2

Në nenin 51, paragrafi (3), pas pikës d) shtohet pika e re gj), si vijon:
“gj) i plotëson kushtet për realizimin e të drejtës për pension, në pajtim me ligj;
Pikat gj) dhe e) bëhen pikat e) dhe zh).

Neni 3

Në nenin 52-a, në paragrafin (6) fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë” zëvendësohen me fjalët: “Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative, Procedurë të Marrëdhënies së Punës dhe Mbikëqyrje Inspektuese në Shkallë të Dytë”.

Neni 4

Në nenin 55, paragrafi (3), në pikën a), nenin 57, nenin 70, nenin 73, në paragrafët (1) dhe (2) dhe në nenin 98, paragrafi (1), në pikën v) fjalët: “Ministria e Punës dhe Politikës Sociale” zëvendësohen me fjalët: “Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve”.

Neni 5

Në gjithë tekstin e Ligjit fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.